




Pranuar / Doretuar Priljenor/Prodato Received/Delivery	07-03	2023	3	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org. Unit	Nr Prof Bi Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRINSHOCK	2459/2023		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.110/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.110/2023 të datës 23.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit /Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.110/2023 e datës 23.01.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet vendimi nr.111-1133/4 i datës 22.12.2022 për refuzimin e ankesës së ankueses nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë.

III. Obligohet Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses të datës 08.12.2022.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.



## Arsyetim

Ankuesja përmes e-mailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net, me datën 20.01.2023 ka parashtruar ankesën e cila është regjistruar me datën 23.01.2023 me numër protokollin 663/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.111-1133/4 të datës 22.12.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën "Auditor i Brendshëm" me pretendimet ankimore për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve procedurale dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 16.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli me datën 03.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion me numër protokollin 1309/2023 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër A.nr.110/2023 e datës 23.01.2023 me numër protokollin 663/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 20.12.2023; Çertifikatë e datës 10.01.2020 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se znj me datën 25.09.2019 ka mbrojtur temën e Masterit; Vendimi i datës 21.04.2020 me nr.23/2020 për caktimin e zv.së Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave dhe Transfereve; Vendimi i datës 10.07.2020 me nr.53/2020 për caktimin e zv.së Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave dhe Transfereve; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2020; Diplomë e datës 16.01.2020 Master e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Prishtinë; Diplomë e datës 08.11.2004 me nr.898 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Prishtinë; Çertifikatë e datës 27 prill 2018; Çertifikatë e datës 02.05.2018; Çertifikatë e datës 22.11.2017; Çertifikatë e datës 17.01.20116; Çertifikatë e datës 16.12.2016 ; Çertifikatë e datës 03.11.2016; Çertifikatë e datës 21.04.2015; Çertifikatë e datës 15.06.2013; Çertifikatë e datës 12.03.2012; Çertifikatë e datës 18.12.2012; Çertifikatë e datës 08.05.2012; Çertifikatë e datës 05.08.2004; Çertifikatë e datës 18.01.2002; Çertifikatë e datës 10.10.2001; Çertifikatë e datës 28.07.2000; Çertifikatë e datës 17.09.2000; Vendimi i datës 12.11.2012 me nr.ZK-60/12; Vendimi i datës 18.12.2014; Vendimi i datës 29.09.2014 me nr.04/2014; Fletërekomandi i datës 31.12.2011; Vërtetim i datës 10.05.2016 i lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Vërtetim i datës 18.10.2013, Vërtetim i datës 09.07.2002; E-mail zyrtar i datës 30.05.2016; E-mail zyrtar i datës 23.05.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 (jo i plotë) prej datës 01.04.2021 deri më datën 31.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 03.02.2023 nga organi i punësimit me numër protokollin 1309/2023; Kopja e konkursit e datës 16.11.2022; Lista e aplikantëve në Sistemin për menaxhimin e burimeve njerëzore; Lista e kandidatëve të refuzuar; Aplikacioni i datës 08.12.2022 i Vendimi i datës 15.12.2022 për



refuzimin e aplikacionit; vendimi i datës 22.12.2022 për refuzimin e ankesës; Ankesë e datës 21.12.2022 e parashtruar në Njësinë e Burimeve Njerëzore në MAPL; Akt emërimi i datës 07.12.2011; Dëshmi për masë disiplinore i datës 25.02.2022; Aplikacioni i datës 01.12.2022 për Sh.Xh; Akt emërimi i datës 03.06.2012; Çertifikatë e datës 01.06.2017; Diplomë e datës 28.10.2008 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diplomë e Masterit e datës 09.12.2019 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; kopja e letërnjoftimit; Licencë e datës 05.09.2011; Vërtetim i datës 28.09.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Aplikacioni i datës 08.12.2022 për A. S P; Akt emërimi i datës 25.07.2022; Akt emërimi i datës 11.04.2012; Çertifikatë e datës 12.10.2016; Çertifikatë e datës 23.07.2012; Çertifikatë e datës 08.05.2012; Çertifikatë e datës 13.10.2010; Çertifikatë e datës 12.03.2021; Çertifikatë e muajit dhjetor 2017; Çertifikatë e datës 23.04.2015; Çertifikatë e datës 26.01.2013; Çertifikatë e datës 29.01.2017; Çertifikatë e datës 30.07.2012; Diploma e datës 31.10.2013 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diploma master e datës 24.01.2017 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të lartë e datës 12.06.2007; Kopja e letërnjoftimit; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 01.06.2022; Letër rekomandimi e datës 11.04.2012; Letër rekomandimi e datës 06.07.2015; Vendim për pushim të lehonisë i datës 17.08.2020; Vendimi i datës 13.03.2020 me nr.01/09 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vërtetim i punësimit për të punësuarën në Policinë e Kosovës i datës 08.12.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë prej datës 01.01.2020 deri në 31.03.2020 dhe Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021.

Kolegji për Shqyrtimin Vendorsjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 16.11.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të Konkursit me numër reference RN00010392 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Auditor i Brendshëm", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Në fazën e verifikimit paraprak, Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me vendimin e datës 15.12.2022 me nr.111-1133/2, ka njoftuar ankuesen për refuzimin e aplikacionit me arsyetimin se e njëjta nuk e ka bashkangjitur vlerësimin e punës për vitin 2021.

Ankuesja me datën 21.12.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal kundër vlerësimit të aplikacionit për pozitën Auditor i Brendshëm. Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin e datës 22.12.2022 me nr.111-1133/4 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar duke lënë në fuqi vendimin nr.111-1133/2 të datës 15.12.2022.



Brenda afatit ligjor ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me rastin e refuzimit të aplikacionit, ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht : Ligjin Nr.06/1-114 për Zyrat e Publikë, neni 38 me të cilin është përcaktuar se: *"Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nën paragrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji...."*, rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 40 ku thuhet se: *"...2. Lëvizja brenda kategorisë është procedurë konkurrese. Konkurrimi organizohet për secilën pozitë të lirë. 3. Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil..., nenin 41 ku parashihet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurimit. 2. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë"* dhe nenin 45 ku theksohet se" 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. Andaj nga provat e bashkangjitura nga ankuesja dhe organi i punësimit Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja i ka plotësuar kriteret e konkursit sepse e njëjta në aplikacion e ka pasur të bashkangjitur vlerësimin për rezultatet në punë për vitin 2021 prej datës 01.04.2021 deri më datën 31.12.2021, këtë e ka cek edhe Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se edhe për faktin se në Aplikacionin e refuzuar të gjitha kriteret e konkursit që janë cek ankuesja i ka plotësuar : kriterin formal për pozitën Auditor i Brendshëm, ku kërkohet arsimimi:

*Diplomë e studimeve universitare në ekonomik, juridik, administratë publike, financa publike me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e*



*diplomës bachelor dhe master, fusha e diplomës master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializimi) i diplomës bachelor:*

*Çertifikatë të auditorit të brendshëm në sekrorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose Çertifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave:*

*Së paku dy (2)vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit vlerëson se organi i punësimit gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me rastin e nxjerrjes së vendimit për refuzimin e aplikacionit të datës 15.12.2022 me nr.ref.RN00010392, gabimisht ka zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.06/1-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në ri procedurë duhet të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Ndërsa ndërlidhur çështjen që u potencue më lartë në lidhje me mos vlerësimin prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.03.2021, ankuesja ka parashtruar ankesë A.nr.453/2022 të datës 13.05.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 2785/2022 me pretendimin ankimor kundër vlerësimit të rezultatit të punës për vitin 2021 dhe mosvlerësim të punës për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datën 01.04.2021. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.06.2022 ka nxjerr vendimin me numër protokolli 3751/2022 me të cilin vendim ka aprovuar ankesën e ankueses me që rast ka ndryshuar vlerësimin dhe poashtu ky vlerësim sipas këtij vendimi është për vitin 2021, që nënkupton se e njëjta ka vlerësimin e tërësishëm për vitin 2021, dhe mbi bazën e mungesës së vlerësimit nga data 01.01.2021 deri me datën 01.04.2021, refuzimi i aplikacionit është pa bazë ligjore, nga se ky vendim ka qenë i formës së prerë ku njëkohësisht është obliguar Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Transfereve, që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, ndërsa poashtu vlen të theksohet se ankuesja ka aplikuar edhe në Ministrinë e Shëndetësisë në konkursin e datës 21.09.2022 me nr.reference RN00009924 në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit të cilës ju ka pranuar aplikacioni me të njëjtin vlerësim të vitit 2021, andaj mbi këto arsye të specifikuar më lartë kolegji i këshillit konstaton se pretendimi i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.

Andaj mbi bazë të asaj që u tha më lartë, kolegji i këshillit e ka aprovuar ankesën dhe njëkohësisht e obligon Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit

të Pushtetit Lokal, që konformë udhëzimeve në arsyetim të këtij vendimi të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të pikës II dhe të III të këtij vendimi.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.110/2023, datë 07.03.2023.

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



#### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

